



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.312/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Kujtim Pasuli dhe Skënder Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Abedin Kabashi, kandidat për asamble komunale në Komunën e Istogut, nga radhët e subjektit politik LDK, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.312/2025, e datës 22.10.2025, e parashtruar nga Abedin Kabashi, kandidat për asamble komunale në Komunën e Istogut, nga radhët e subjektit politik LDK, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 22.10.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.312/2025, nga Abedin Kabashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e subjektit politik LDK, për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), me të cilën pretendohet sa ka pasur parregullsi gjatë procesit të pranimi të fletëvotimeve përmes postës ku një numër i konsiderueshëm prej rreth 99 fletëvotimeve me vota nuk figurojnë në kutitë përkatëse, vota këto të dërguara nga familjare të ngushtë. Tutje ka theksuar se pavarësisht se këto vota janë dërguar brenda afateve ligjore dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga KQZ, gjatë numërimit të tyre është vërejtur mungesa e tyre e pashpjegueshme. Kanë kërkuar nga PZAP të urdhëroj verifikimin e plotë të procesit të pranimi të fletëvotimeve nga kutitë postare të KQZ-së në 22 shtete të ndryshme dhe në kutinë postare të KQZ-së, ruajtjes dhe numërimit të votave me postë në Komunën e Istogut, me qëllim të identifikimit të shkaqeve të mos pasqyrimit të 99 votave. Në ankesë ka bashkangjitur kopjen e dokumentit të tij identifikues dhe listën e fletëvotimeve.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 23.10.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), kanë deklaruar se me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti

sipas komunave të votuesve. Tutje, në përgjigje theksohet se bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR përkatësisht në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara me nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të krahasimit të listave të votuesve në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Gjatë procesit të numërimit në QNR, numërimi i votave bëhet në transparencë të plotë, ku fletëvotimi prezantohet në ekran dhe shihet nga vëzhguesit e akredituar. Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklaratimet e personave, duhet theksuar se në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të LPZ-së Nr.08/L-228, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e qytetarëve.

Tutje, kanë theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e Abedin Kabashi, kandidat për anëtarë të asamblesë komunale kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e subjektit politik LDK, se *“pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të ardhura me postë, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i votave- rreth 99 fletëvotime me vota- nuk figurojnë në kutitë përkatëse- se ka pasur mospranim, mos regjistrim, humbje ose trajtim të pasakte të këtyre fletëvotimeve”* janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se i njëjti nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se i mungojnë 99 vota me postë, të cilat pretendon se kanë votuar, ndërsa ankesës nuk i ka bashkëngjitur prova konkrete dhe bindëse, dhe nuk ka arritur të argumentoj pretendimet e shprehura në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese, duke dërguar një listë me emra dhe mbiemra, nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se ka ekzistuar shkelja e pretenduar.

Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesi i ankesës nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3

të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mospërputhje gjatë numërimit të votave me postë për Komunën e Istogut.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.312/2025 me datën 24.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.